



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.36, datë 29.09.2008

**PËR "PËRCAKTIMIN E FORMËS SË DHËNIES ME KONCESION TË DY
PARKIMEVE NËNTOKËSORE NË QYTETIN E TIRANËS"**

Në mbështetje të Ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 për "Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" (i ndryshuar); neni 8/1/II, gërmat "a" dhe "c", si dhe nenit 32, gërma "e"; Ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 për "Konçesionet"; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.27, datë 19.01.2007 për "Miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së konçesioneve" (i ndryshuar); Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1181, datë 23.07.2008 për "Përcaktimin e autoritetit kontraktues, për dhënien me konçesion të parkimit nëntokësor në Parkun "Rinia" dhe miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë" dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1182, datë 23.07.2008 për "Përcaktimin e autoritetit kontraktues, për dhënien me konçesion të parkimit nëntokësor në Sheshin "Italia" dhe miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë"; Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.61, datë 10.11.2006 për "Zhvillimin e infrastrukturës së disa parkimeve nëntokësore në qytetin e Tiranës", me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I :

1. Lloji i konçesionit të dy parkimeve nëntokësore në Parkun "Rinia" dhe në Sheshin "Italia" pranë stadiumit "Qemal Stafa" në qytetin e Tiranës, do të jetë i formës BOT (ndërtim, operim dhe transferim).
2. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë së Tiranës për ndjekjen e mëtejshme të procedurave ligjore konçesionare.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohen strukturat përgjegjëse në Bashkinë e Tiranës.
4. Ky Vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

Petraq SIMO

ZV/ K R Y E T A R